



PUSHTETI DHE OPOZITA 'PËRPLASEN' NË KUVEND PËR BUXHETIN E 2025-S

FAQE 4-5



Deputetët e Kuvendit të Kosovës, të pushtetit dhe të opozitës, kanë diskutuar të hënën rreth shqyrtimit të parë të Projektligjit për Buxhetin e

Kosovës për vitin 2025. Deputetët e pozitës kanë thurur lavde për këtë buxhet, kurse deputetët e opozitës kanë theksuar se buxheti i vitit 2025

nuk kontribuon në përmbushjen e nevojave të qytetarëve. Projektligji i Buxhetit për vitin 2025 arrin nivelin prej 3.608 miliardë eurosh

KURTI PËR MARRËVESHJEN E UASHINGTONIT: SË PARI AJO E BRUKSELIT F. 3



INSTITUTI GAP: NË VITIN 2023 TRANSPARENCA BUXHETORE E KOMUNAVE PATI RËNIE F. 4



OPINION

OBJEKTIVAT E ADMINISTRATËS REPUBLIKANE TË VITIT 2025 PËR BALLKANIN DHE KOSOVËN F. 6

Shkruan: Prof. dr. Fejzulla BERISHA, Philadelphia, ShBA



AKTUALE



BALLKANI PERËNDIMOR DHE NDIKIMI I PAPANSHIKUESHËM I TRUMPIT F. 2

VDEKJA E PJESËTARIT TË FSK-SË, REAGON KMDLNJ: TË RESPEKTOHEN MASAT MBROJTËSE NË NDËRTIM-TARI F. 3

HOXHAJ: KOSOVA KA NJË QEVERI TË PAPËRGJEGJSHME, VETËM ME INTERESA ELEKTORALE, PA KURRFARË INTERESI SHTETËTOR F. 5

EKONOMI



BUXHETI 2025: RITJE FONDESH PËR MBROJTJE, INFRASTRUKTURË... F. 8

TRI KOMUNA TË UDHËHEQURA NGA PDK-JA, KAMPIONE PËR TRANSPARENÇË BUXHETORE F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ballkani Perëndimor dhe ndikimi i paparashikueshëm i Trumpit

UASHINGTON, 11 NËNTOR - Presidenti i zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, nuk është i huaj për Ballkanin Perëndimor, as rajoni nuk është i panjohur për të. Historitë e tyre janë të ndërthurura dhe kanë krijuar tashmë terren për një marrëdhënie të paparashikueshme përpara.

Trumpi, republikan, i cili ka shërbyer president edhe nga viti 2017 deri më 2021, ka fituar zgjedhjet e 5 nëntorit kundër kandidatës demokrate Kamala Harris. "Sinqerisht, kjo ishte lëvizja më e madhe politike e të gjitha kohëve. Nuk ka pasur kurrë diçka të tillë në këtë vend, ndoshta edhe më gjerë", ka thënë Trumpi natën e zgjedhjeve.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministri Albin Kurti e kanë uruar atë për fitoren.

Kurti ka thënë se "ShBA-ja është një aleate, mike dhe partnere e rëndësishme e Kosovës" dhe se "ne mezi presim të punojmë së bashku për përparim dhe paqe". Për "fitoren e jashtëzakonshme" e ka uruar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe udhëheqës të tjerë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili ka shprehur besimin se zëri i Serbisë "tani do të dëgjohej më mirë". "Me [njerëzit e Trumpit] kemi ruajtur marrëdhënie miqësore edhe kur e kanë humbur mandatin dhe kjo tani është një situatë më e përshtatshme për ne", ka thënë Vuçiqi.

Entuziast për fitoren e Trumpit është shprehur edhe kryeministri i Malit të Zi, Milo Djukanović, i cili në një postim në "X" ka shkruar se "ditë më të mira" do të vijin si për Amerikën, ashtu edhe për Malin e Zi.

Ndërsa presidenti i Republikës Sërpska, Millorad Dodik, i cili favorizon shkëputjen e këtij entiteti nga pjesa tjetër e Bosnjës, ka thënë se fitorja e Trumpit "është edhe fitorja jonë".

Administrata e mëparshme "ishite e padrejtë me ne"; nën udhëheqjen e Trumpit, presim që ajo të jetë më objektive, ka thënë Dodiku - i sanksionuar nga ShBA-ja për rrezikimin e Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe.

Reagimet e tilla për Vesko Garçevićin, profesor i Praktikës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Bostonit, ishin të pritshme. Për më tepër, thotë ai, ekziston prej kohësh një qasje proaktive e disa liderëve ballkanikë për t'i forcuar pozitën e tyre dhe për të luajtur rol në formësimin e politikës amerikane ndaj Ballkanit. "Dy



shtete të rajonit, Serbia dhe Shqipëria, i kanë ofruar hapësirat e tyre për investime nga rrethi i ngushtë i Trumpit, duke shpresuar se një gjë e tillë do t'u ndihmojë të merren me administratën Trump në të ardhmen". "Kur bëhet fjalë për Serbinë, ajo beson se kjo administratë do t'i ndihmojë ta adresojë çështjen e Kosovës. Shqipëria, ndërkaq, përpiqet ta pozicionojë veten si një nga shtyllat - së bashku me Serbinë - e qasjes së ardhshme amerikane ndaj Ballkanit", thotë Garçević për programin "Expose" të "Radios Evropa e Lirë".

Dhëndri i Trumpit, Jared Kushner, i cili ka shërbyer edhe këshilltar në administratën e tij, planifikon të ndërtojë hotele luksoze në Shqipëri dhe Serbi. Edhe djali i madh i Trumpit, Donald Jr., ka darkuar këtë vjeshtë me biznesmenë në Beograd, për të diskutuar për mundësitë për investime.

Për Garçevićin janë të njohura tendencat e Trumpit për interesat amerikane përmes marrëdhënieve dypalëshe. "Trumpi nuk do ta harmonizojë qasjen e Amerikës me Bashkimin Evropian, nëse beson se qasja individuale, qasja dypalëshe i sjell përfitime më të mira. Ai do t'i shtyjë gjërat përpara, pavarësisht se çka

mendon BE-ja", thotë ai.

David Kanin, profesor i Studimeve Evropiane në Universitetin "Johns Hopkins" në Uashington, thotë për "Exposën" se administrata e parë e Trumpit ka qenë proserbe dhe se zyrtarët serbë janë ndierë të respektuar prej tij.

Ndonëse thekson se presidenti i zgjedhur është i paparashikueshëm, ai pret që kjo marrëdhënie të vazhdojë. Thotë se investimet në Shqipëri për të do të jenë të rëndësishme, ndërsa forcat populiste në Maqedoni të Veriut dhe në Mal të Zi do të përshtaten me kërkesat e tij, për t'i maksimizuar përfitimet e tyre. "Humbësit, si gjithmonë, janë klientët e Amerikës: boshnjakët dhe kosovarët. Por, për këtë nuk duhet të fajësohet vetëm Trumpi. Ne kemi 30 vjet që i detyrojmë boshnjakët dhe kosovarët të bëjnë lëshime ndaj kundërshtarëve të tyre - qysh nga Marrëveshja e Dejtonit", thotë Kanin.

Kanin shton se boshnjakët janë tani të humbur dhe pa mbrojtës, duke supozuar se Trumpi do të vazhdojë të mbetet, siç thotë, proserb. Ai vë në dukje se kroatët e Bosnjës mund t'i rinovojnë përpjekjet për një entitet të tretë dhe boshnjakët të dobësohen prej

kësaj. Për Kosovën thotë se, prej kohësh, nuk po i shkonte mirë në aspektin ndërkombëtar. "Albin Kurti mund t'i fitojë zgjedhjet në Kosovë, por jashtë vendit është shumë jopopullor. Tani ai do të përballë me Shtetet e Bashkuara të cilat mund të jenë edhe më të prira për ta ndihmuar Vuçiqin me politikën e tij ndaj Kosovës", thotë Kanin.

Gjatë administratës së parë Trump, Kosova dhe Serbia kanë arritur një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike, por shumica e pikave të saj kanë mbetur pa u zbatuar. Në atë administratë ka pasur edhe zyrtarë që kanë folur për shkëmbimin e territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë - si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre - por edhe për tërheqjen e trupave amerikane nga Kosova.

Kanin thotë se gjasat për t'u rikthyer si ide i ka më shumë kjo e fundit. "Shkëmbimi i territoreve nuk do të rikthehet në të njëjtën mënyrë si përpara, sepse aktorët kanë ndryshuar - së paku njëri prej tyre. Marrëveshja është folur në kuadër të një pajtimi mes [ish-presidentit të Kosovës, Hashim] Thaçi, dhe Vuçiqit, të cilët i kanë besuar njëri-tjetrit. Problemi tani është se në mes të Kurtit

dhe Vuçiqit nuk ka bashkëpunim. Ndaj, besoj se marrëveshja mes tyre nuk ka gjasa", thotë Kanin.

Por, ndryshe nga ai mendon Garçević. Sipas tij, ideja e shkëmbimit të territoreve mund të rishfaqet shpejt në agjendën e ShBA-së. "Mendoj se ShBA-ja nuk do të dojë një krizë tjetër në Ballkan. Ajo do të përpiqet ta mbyllë edhe krizën në Ukrainë, për t'u përqendruar te Kina dhe kriza e saj potenciale me Tajvanin. Nëse i marrim parasysh të gjitha ato që Trumpi i ka thënë gjatë fushatës presidenciale, mendoj se Kina do ta marrë pjesën më të madhe të kohës kur bëhet fjalë për agjendën e politikës së jashtme", thotë Garçević.

Të dy bashkëbiseduesit e REL-it thonë se sfidat për Kosovën do të jenë më të theksuara sidomos nëse Richard Grenell merr pozitën e sekretarit amerikan të Shtetit apo ndonjë pozitë tjetër të lartë në administratën e re Trump - gjë që tashmë është përfolur.

Në vitin 2020 kryeministri i Kosovës, Kurti, e ka akuzuar Grenellin, i cili atëkohë ka qenë përfaqësues i Shteteve të Bashkuara në dialogun Kosovë - Serbi për "përfshirje të drejtpërdrejtë" në rrëzimin e qeverisë së tij.

Grenelli ka thënë se Kurti është anti-amerikan.

Përballë sfidave të brendshme, luftës në Ukrainë, konflikteve në Lindjen e Mesme e të tjera, ka edhe analistë që argumentojnë se administrata e re e Trumpit mund t'i injorojë zhvillimet në Ballkan dhe kështu t'i mundësojë Rusisë ta zgjerojë ndikimin e saj.

Një prej tyre është Cody McClain Brown, profesor në Universitetin e Zagrebit. "Nëse Rusia përpiqet të ndikojë më shumë në Serbi dhe në Mal të Zi, situata në Bosnjë-Hercegovinë mund të bëhet më e paqëndrueshme. Kur bëhet fjalë për Kosovën, qëndrimi i Trumpit do të vazhdojë të rrijë pezull. Ai mund ta mbështesë Serbinë për ta rimarrë Kosovën, por është vështirë të dihet, pasi nuk shpreh opinione të fuqishme për këtë çështje", thotë Brown.

Bashkimi Evropian, ku mëtojnë anëtarësimin të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, po shtrëngohet për kthimin e Trumpit. Zyrtarët e tij e kanë uruar atë, por në të kaluarën kanë shprehur jo rrallë shqetësime për politikën e tij të jashtme.

Analistët thonë se në muajt e parë të vitit të ardhshëm e andej, do të bëhet e qartë nëse taktikat e Trumpit do të çojnë në zhvillime pozitive në Ballkanin Perëndimor, do t'i shtojnë armiqësitë apo do ta lënë atë, thjesht, në një gjendje amullie.

Vdekja e pjesëtarit të FSK-së, reagon KMDLNj: Të respektohen masat mbrojtëse në ndërtimtari

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Pas vdekjes tragjike të një pjesëtarit të FSK-së të shtunën e javës së kaluar, i cili ka rënë nga një objekt banesor në rrugën "Gucia" në Prishtinë, ka reaguuar Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj). Përmes një reagimi për medie, KMDLNj kërkon që të shtohet numri i inspektorëve të komunës si dhe të ekipeve mobile që do t'i inspektonin kantieret e ndërtimit.

"Limon Musliu, pjesëtar i FSK-së

humbi jetën pasi ra nga kati i 11 - të i një ndërtese ku ishte duke punuar, si punë shtesë. KMDLNj edhe më parë ka kërkuar që punëtorët në ndërtimtari të kenë kushte të përshtatshme për punë duke mos iu ekspozuar rrezikut nga lëndimet apo për jetën e tyre. KMDLNj ka kërkuar që të shtohen numri i inspektorëve të punës, ekipeve mobile që do të inspektonin kantieret e ndërtimit, nëse respektohen rregullat apo standardet për të punësuarit e që do të garantonte sigurinë e tyre. Megjithatë duket se është një shpërputhje e madhe midis numrit



të vogël të inspektorëve të punës dhe vendeve të shumta që duhet të inspektohen në fushën e ndërtimit andaj KMDLNj rekomandon institucionet të angazhojnë ndonjë kompani të specializuar që ka kapacitet fizik dhe profesional të mbikëqyrë vendpunimet në mënyrë që të parandalohen rastet e ngjashme në të ardhmen", thuhet në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se gjykatat duhet t'i japin përparësi trajtimit të këtyre rasteve duke mbrojtur interesit e punëtorëve që pësojnë lëndime, invaliditet apo kanë përfundim fatal.

Instituti GAP: Në vitin 2023 transparencja buxhetore e komunave pati rënie

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Instituti GAP ka publikuar raportin e tetë mbi transparencën buxhetore të komunave në Kosovë. Sipas njoftimit të GAP-it, ky raport vlerëson transparencën buxhetore bazuar në numrin e dokumenteve buxhetore të publikuara, organizimin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë, si dhe përgjigjeve të komunave në kërkesat e institutit GAP për qasje në dokumente publike. Ndër të tjera, thuhet se, ndryshe nga trendi në tri vitet e fundit, në vitin

2023 transparencja buxhetore e komunave pati rënie, me një mesatare të pikëve prej 57.5.

"Kjo rënie në vitin 2023 është ndikuar në veçanti nga problemet teknike për qasje në uebfaqet e pesë komunave, si: Skenderaj, Peja, Kamenica, Mitrovica e Jugut dhe Prizreni, për të cilat këtë vit nuk është bërë vlerësim. Kjo është bërë me qëllim që të mos penalizohen këto komuna për shkak të problemeve që nuk varen prej tyre, duke pasur parasysh se menaxhimi i uebfaqeve të komunave është kompetencë e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI)", thuhet në njoftimin e GAP-it.

Sipas këtij njoftimi, gjithsej 20 komuna kaluan mesataren e pikëve gjatë vitit 2023 dhe katër komuna arritën maksimumin prej 100 pikësh (Komuna e Drenasit, e Vushtrrisë, e Lipjanit dhe e Hanit të Elezit). "12 komuna kanë shënuar progres në vlerësimin me pikë krahasuar me vitin paraprak, 16 komuna kanë shënuar regres, ndërsa 5 komuna kanë pikë të njëjta sikur vitin e kaluar. Në total, nga 33 komunat e vlerësuara, ato publikuan 207 dokumente buxhetore. Dokumentet më të publikuara për 2023-n ishin raportit vjetor financiar dhe rregullorja për ndarjen e subvencioneve", ka njoftuar GAP-i.



Delegacioni frankofon viziton Kosovën, Kurti thekson rëndësinë e gjuhës frënge

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim një delegacion të Asamblesë Rajonale të Evropës, pjesë e Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë (APF), kryesuar nga senatorja belge Anne Lambelin.

Gjatë takimit u konfirmuan vlerat e përbashkëta që Kosova dhe Asambleja Parlamentare e Frankofonisë ndajnë, sikurse janë diversiteti kulturor dhe gjuhësor, të drejtat e njeriut e solidariteti.

Kryeministri vlerësoi bashkëpunimin dhe nënvizoi fushën e filmit si fushë me potencial të bashkëpunimit, dhe mësimin e gjuhës frënge si instrument për të njohur dhe përafuar edhe më shumë popujt e dy vendeve, si dhe

për ta rritur mobilitetin studentëve dhe profesionistëve në shërbim të shkëmbimeve kulturore, rritjes së kompetencave dhe zhvillimit socio-ekonomik. Ai shprehu vullnetin që institucionet publike arsimore t'i rrisin kapacitetet e mësimin të gjuhës frënge.

Anëtarët e delegacionit falënderuan kryeministrin për mikpritjen dhe takimin dhe shprehën kënaqësinë që për herën e parë APF-ja zhvillon një vizitë të tillë disaditësh në Kosovë.

Nga viti 2022 Kuvendi i Kosovës ka statusin e anëtarit të asociuar në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë (APF) dhe ka synim të avancojë në të ardhmen drejt anëtarësimin të plotë.



Osmani dhe rektori i UP-së bisedojnë për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim rektorin e Universitetit të Prishtinës, Arben Hajrullahu, të cilin e ka

uruar për marrjen e pozitës në krye të Universitetit të Prishtinës.

Gjatë takimit, presidentja është njoftuar për sfidat me të cilat përballlet UP-ja.

Presidentja Osmani e ka falënderuar rektorin Hajrullahu për përpjekjet për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë si dhe ka shprehur përkrahjen e plotë

të Presidencës drejt avancimit dhe fuqizimit të Universitetit të Prishtinës, duke përfshirë këtu edhe avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.





Pushteti dhe opozita 'përplasen' në Kuvend për buxhetin e 2025-s

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, të pushtetit dhe të opozitës, kanë diskutuar të hënën rreth shqyrtimit të parë të Projektligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2025. Deputetët e opozitës kanë thurur lavde për këtë buxhet, kurse deputetët e pushtetit kanë theksuar se buxheti i vitit 2025 nuk kontribuon në përmbushjen e nevojave të qytetarëve. Projektligji i Buxhetit për vitin 2025 arrin nivelin prej 3.608 miliardë eurosh

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë diskutuar të hënën rreth shqyrtimit të parë të Projektligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2025. Ata kanë shqyrtuar projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2025, të propozuar e miratuar nga qeveria në vlerë prej 3.608 miliardë eurosh.

Kryeministri Albin Kurti para deputetëve ka paraqitur buxhetin për vitin 2025. Ai ka thënë se ky është buxhet i ri me një qeveri në mandatin e së cilës ekonomia e vendit vazhdon të rritet nga një miliard euro në vit. Kurti ka thënë se me këtë buxhet kanë prioritet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, vazhdimin e krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjen e mirëqenies për të gjithë. Sipas tij, për vitin e ardhshëm presin që rritja ekonomike të arrijë në 5.6 % të Bruto Produktit Vendor në terma realë, dhe synimi i tyre është që këtë rritje ta bëjnë duke

i përfshirë të gjithë, "ashtu siç na takon, ashtu siç e meritojnë qytetarët, duke mos e lënë asnjëri anash". "Kam nderin dhe kënaqësinë që sot para jush të bëhem kryeministri i parë që prezanton buxhetin e katërt të mandatit, për ta shënuar kështu edhe qeverinë e parë që e çon mandatin deri në fund. Siç tashmë edhe e dini, buxheti për vitin 2025 është projektuar të jetë 3.6 miliardë euro apo rreth 9 % më i lartë sesa buxheti i vitit 2024, ose 60 % më i lartë sesa buxheti i vitit 2020. Për të arritur deri këtu, këto katër vjet kaluam nëpër shumë sfida, globale dhe të brendshme. Por, njëkohësisht, e për dallim nga të tjerët para nesh, u siguroam që buxheti të orientohej aty ku kthimi ishte më i larti, te qytetarët tanë. Duke bërë këtë, vit pas viti, rritej edhe buxheti, pa ndryshuar asnjë politikë tatimore, sepse investimi në qytetarët tanë vazhdon të kthehet në rritje të qëndrueshme.

Buxheti i vitit 2025 është buxheti i katërt me radhë që po e prezantojmë si qeveri në këtë

mandat. Miratimin në qeveri dhe prezantimin e buxhetit në Kuvend çdoherë e kemi bërë sipas rregullave të përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Buxhetin për vitin 2022 në Kuvend e kemi prezantuar më 25 nëntor 2021. Buxhetin për vitin 2023 e kemi prezantuar më 17 nëntor 2022. Buxhetin për vitin 2024 më 16 nëntor 2023 dhe sot, buxhetin për vitin 2025, përsëri po e prezantojmë në muajin nëntor, madje kësaj radhe në gjysmën e parë të këtij muaji. Më i madh buxheti i shtetit secilin vit, aq më i hershëm edhe prezantimi i tij në Kuvend secilën herë", ka theksuar Kurti.

Ai ka thënë se si qeveri e përgjegjshme ndërmorën veprime të nevojshme dhe ndan pakon më të madhe mbështetëse për qytetarët, ashtu që çmimet stratosferike nga bursat ndërkombëtare të importit të energjisë elektrike, të mos barteshin edhe te qytetarët e bizneset. "Mijëra familje i mbështetëm në renovimin dhe izolimin e shtëpive ashtu që të ullej konsumin e energjisë elektrike dhe kjo vazhdon edhe tani kur po afrohen javët e muajt e fundit të mandatit tonë. Subvencionuam edhe mijëra familje të tjera për të blerë pajisje eficiente, përfshirë edhe kondicionerët me ngrohje që shpenzojnë pak, ashtu që faturat e energjisë elektrike të peshonin sa më pak në arkën e familjes. I mbështetëm edhe ata që kursyen energjinë elektrike, ku mbi 208 mijë familje për gjashtë muaj me radhë përfituan nga mbulimi i një pjese apo komplet faturës, varësisht se sa kishin

kursyer. Pra ata që kursejnë, i shpërblejmë. Si rezultat i këtyre masave, Kosova vazhdon ta ketë çmimin më të lirë të energjisë elektrike në rajon, sipas Eurostat, dhe kjo është një karakteristikë tejet e rëndësishme për investimet e huaja dhe rinvestimet që bëhen në Kosovë", ka thënë ai. Kryeministri Kurti ka pohuar se sikur të mos mjaftonte kriza energjetike në Evropë, Federata Ruse hapi front duke sulmuar Ukrainën, gjë që çrregulloi të gjitha bursat botërore të çmimeve, sidomos ato të ushqimeve bazë. "Pasojat u vërejtën në tërë kontinentin. Edhe kësaj radhe Kosova nuk kishte se si t'i evitonte pasojat njësoj sikurse shtetet që janë shumë më të fuqishme ekonomikisht sesa ne. Edhe për këtë sfidë ndërmorëm masat e nevojshme duke miratuar Pakon për Përballje me Inflacionin, përmes së cilës mbështetëm punëtorët e sektorit privat e publik, pensionistët dhe studentët dhe kjo pako si përqindje e Bruto Produktit Vendor është më e madhja në rajonin tonë sipas Bankës Botërore. Si pjesë të pakos miratuar edhe Ligjin për Pagën Minimale për ta mundësuar rritjen e pagës minimale në sektorin privat, si dhe Ligjin për Çmime Tavan që të parandalohet abuzimi i tregtarëve të papërgjegjshëm që manipulonin me çmime", ka theksuar Kurti, duke shtuar se ky buxhet është buxhet për familjen.

E deputetët e opozitës e kanë kritikuar këtë buxhet. Deputeti i LDK-së, Avdullah

Hoti, e ka kritikuar qeverinë Kurti rreth hartimit të projektbuxhetit për vitin 2025. Hoti ka thënë se ky projektbuxhet ka së paku dy shkelje ligjore, sidomos te tatimi në pronë dhe Ligji i Pagave. "Ky projektbuxhet tregon abuzimin e qeverisë me autoritetet e veta ligjore duke lënë zëra të paspecifikuar në buxhet te subvencionet. Po e mira është që ky buxhet është transitor", ka theksuar Hoti.

Ai shtoi se qeveria e ardhshme do të ketë prioritet ndryshimin e këtij buxheti, fillimisht për t'i rritur pagat, pensionet dhe skemat sociale për normën e inflacionit "Për t'i buxhetuar projektet kapitale dhe për t'i shpërndarë nëpër sektorë dhe komuna sipas nevojës, për ta buxhetuar skemën e sigurimeve shëndetësore, arsimin dhe shëndetësinë, kontratën kolektive që është bërë kaos, ushtrinë dhe institucionet e tjera. Për ta kthyer ligjshmerinë dhe për t'i mbledhë buxhet që kthehet prapë te qytetarët e Kosovës", është shprehur Hoti. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Mërgim Lushtaku, në fjalimin e tij në Kuvend, ka thënë se gjatë qeverisjes së Albin Kurti nuk ka ndodhur asnjë projekt madhor. Ai e ka kritikuar pushtetin, ndërsa ka thënë se po bëjnë disa mashtrime për buxhetin e shtetit.

"Po mbajmë një ndër seancat më të rëndësishme të këtij viti, duke qenë se ligji ka rëndësi të veçantë dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë te qytetarët dhe te vendi ynë. Asnjë projekt madhor nuk mbahet mend për këtë kohë

Kurti për marrëveshjen e Uashingtonit: Së pari ajo e Brukselit

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se dëshiron që marrëveshja e Brukselit e arritur vitin e kaluar me Serbinë, të zbatohet fillimisht, më pas të trajtohet ajo e Uashingtonit.

I pyetur nëse është e pranueshme për të tani marrëveshja e Uashingtonit e arritur më 2020 në Shtëpinë e Bardhë - nëse administrata e re amerikane e Donald Trumpit, insiston në zbatimin e saj, Kurti tha se pret që marrëveshja tjetër, ajo e Brukselit, të nënshkruhet. "Unë mund të jem përgjegjës për marrëveshjet në të cilat kam marrë pjesë dhe kam pranuar dhe pres të njëjtën gjë edhe nga Beogradi, edhe pse ai e shtyp dhe nuk e respekton këtë marrëveshje. Le të fillojmë me marrëveshjen e fundit, e cila është një marrëveshje gjithëpërfshirëse, sepse ajo normalizon marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes njohjes de facto të njëra-tjetrës", tha Kurti pas pjesëmarrjeje në një ngjarje në Prishtinë.

Kosova dhe Serbia u pajtuan për Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve vitin e kaluar. Marrëveshja nuk është nënshkruar, por Bashkimi Evropian që ndërmjetëson dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, insiston se ajo është obliguese për palët.

Marrëveshja prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, që Serbia të mos bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Ndërkaq Marrëveshja e Uashingtonit për normalizim ekonomik u arrit në shtator të vitit 2020 në mes të ShBA-së dhe Kosovës e Serbisë në Shtëpinë e Bardhë, në prani të presidentit Donald Trump. Kjo marrëveshje, që përfshiu edhe njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Izraeli, nuk është zbatuar plotësisht.



Hoxhaj: Kosova ka një qeveri të papërgjegjshme, vetëm me interesa elektorale, pa kurrfarë interesi shtetëror

Prishtinë, 11 nëntor - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka thënë se vendi ynë ka një qeveri të papërgjegjshme, e cila ka vetëm interesa elektorale dhe kurrfarë interesi shtetëror. Sipas Hoxhajt, kësaj qeverie i mungon vëmendja dhe vetëdija që ta kuptojë që presidenti në ardhje Donald Trump nuk do ta vazhdojë thjesht politikën e mëparshme. "Në vend të keqpërdorimit të Ministrisë së Jashtme dhe ambasadave për fushatë zgjedhore, qeveria Kurti duhet ta vizitonte Uashingtonin, ta kontaktonte administratën në formim të presidentit Trump dhe t'ia paraqiste prioritetet e Kosovës, meqë Serbia jo vetëm gjatë



fushatës zgjedhore në ShBA, por edhe këto ditë ka dërguar delegacione joformale drejt Nju-Jorkut, Floridas dhe natyrisht në Uashington! Por kur vendi ka një qeveri të papërgjegjshme, e cila ka vetëm interesa elektorale dhe kurrfarë interesi shtetëror, asaj i mungon vëmendja dhe vetëdija që ta kuptojë që presidenti Trump nuk do të vazhdojë thjesht politikën e mëparshme, ku ShBA vetëm do të mbështesë dialogun Kosovë-Serbi dhe Bashkimin Evropian, por mund të jetë e kundërta, ku BE-ja do të ishte vetëm fasilitator, ndërsa ShBA-ja do të zgjidhte çështjet kyçe në Ballkan, duke përfshirë normalizimin e plotë në mes të Kosovës-Serbisë! Së bashku me

rikthimin e Trumpit është kyçe që të rikthehet edhe njohja e ndërsjellë në dialog si prioritet i Kosovës, dhe i ShBA-së", ka shkruar Hoxhaj në "Facebook". Ai ka thënë se kur sot tema kryesore në ShBA është se kush çfarë pozite do të marrë në politikën e jashtme dhe pozitën e rëndësishme përgjegjëse për Evropën dhe Ballkanin, qeveria Kurti është e humbur në një kohë dhe hapësirë për të ndërmarrë ndonjë hap, gjë që tregon se rivendosja e marrëdhënieve me administratën Trump dhe me ShBA-në është vetëm temë e ShBA-së, por edhe e opozitës, që ndryshimi në Uashington të paraprihet edhe me ndryshimin që do të ndodhë në Prishtinë.

që ju qeverisni. Kurti ka premtuar se do ta forcojë ekonominë. Këtë e ka bërë për ta manipuluar popullatën. Besimin e qytetarit e kanë marrë si privilegj, e po mendojnë se në karriget e pushtetit do të qëndrojnë përgjithmonë", ka thënë ai. Lushtaku ka pohuar se buxheti i vitit 2025 nuk kontribuon në përmbushjen e nevojave të qytetarëve. "Kur flasim për planifikimin buxhetor, ku ky shtet nuk ia sheh hairin, që nga fillimi i qeverisë shihet se është e

dobët në planifikim". Një planifikim i mirëfilltë do të kontribuonte në përmbushjen e nevojave të qytetarëve, e që kjo nuk po ndodh me ju", ka thënë ai, duke shtuar se PDK-ja nuk do ta votojë Projektligjin për Buxhetin e vitit 2025.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka bërë disa kritika ndaj pushtetit. Ai ka thënë se qeveria Kurti nuk ka kryer asnjë projekt gjatë këtij mandati. "Qeveria për katër vjet ka pasur 12 miliardë euro buxhet. Nga këto 12 miliardë

euro a ka ndonjë projekt që është nisur dhe është përfunduar, përveç urës së Saradranit? Është ky kabinet që ka dhënë premtim që do t'i rrisë pensionet. I ka rritur 20 euro. Po është rritur ekonomia. 240 milionë euro ua keni dhënë dostave tuaj përmes tenderëve njëburimor", ka thënë ai gjatë fjalimit.

Tahiri ka theksuar se LV-ja ka ardhur në pushtet duke premtuar ulje të çmimeve, por kjo nuk ka ndodhur. Ndërkaq ministri i Financave, Hekuran

Murati, duke iu përgjigjur akuzave të opozitës, ka deklaruar se diçka që është shkatërruar për 20 vjet rresht, s'mund të rikuperohet për një mandat. Ai ka thënë se qeveria e tanishme është e vetmja e cila për katër vjet radhazi ka dyfishuar të hyrat tatimore. "Normalisht që merr kohë derisa të rindërtohet kapaciteti prodhues. Diçka që është shkatërruar për 20 vjet, s'mund të rikuperohet brenda një mandati. Thatë që s'ka pasur rritje të të hyrave, sepse rritja e

buxhetit të të hyrave ka ndodhur për çdo vit me radhë. Në qeverisjen tonë për katër vjet me radhë, ka rritje dyshifrore të të hyrave buxhetore. Nëse e shikojmë të gjithë dekadën kur keni qeverisur ju, janë vetëm dy vjet ku rritja e të hyrave buxhetore ka shënuar rritje dyshifrore. Kanë qenë viti 2011 dhe viti 2016. Ndërsa ne jemi qeveria e vetme ku për katër vjet radhazi kemi pasur rritje dyshifrore të të hyrave tatimore", ka theksuar Murati para deputetëve.

Objektivat e administratës republikane të vitit 2025 për Ballkanin dhe Kosovën



Shkruan:
Prof. Dr. Fejzulla
BERISHA, Philadelphia,
SHBA

I. Stabiliteti dhe zhvillimi ekonomik

II. Kufizimi i ndikimit të Rusisë dhe Kinës në Ballkanin Perëndimor.

Për të kuptuar më mirë qasjen që administrata republikane mund të ketë në rajon, mund të shqyrtojmë disa shembuj konkretë të përvojave të mëparshme dhe objektivave që lidhen me Ballkanin dhe

Kosovën.

I. 1. Stabiliteti dhe zhvillimi ekonomik Shembulli konkret:

Gjatë mandatit të kaluar, Administrata e Trumpit organizoi Marrëveshjen e Uashingtonit në vitin 2020 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, një dokument që synonte përmirësimin e bashkëpunimit ekonomik dhe fillimin e normalizimit të marrëdhënieve. Edhe pse kjo marrëveshje nuk përfshinte njohjen e ndërsjellë, ajo kishte për qëllim lehtësimin e tensioneve dhe përmirësimin e marrëdhënieve përmes bashkëpunimit ekonomik.

Qasja e re e republikanëve në 2025: Republikanët mund të ushtrojnë më shumë presion mbi Kosovën dhe Serbinë për të zbatuar detyrimet e marrëveshjeve të mëparshme dhe për të bërë hapa konkretë drejt një marrëveshjeje përfundimtare. Një shembull mund të jetë që SHBA të vendosë kushte për ndihmën ekonomike ose mbështetjen ushtarake, duke i bërë palët më të përgjegjshme ndaj përmirësimit të marrëdhënieve.

II. 1. Kufizimi i ndikimit të Rusisë dhe Kinës: Rasti i Marrëveshjes për Gazin e Lëngshëm Shembulli konkret:

Gjatë administratës së Trumpit, SHBA shtyu për bashkëpunime energjetike në rajon për të reduktuar varësinë nga energjia ruse. Për shembull, në Greqi dhe Kroaci, u zhvilluan projekte për të përmirësuar furnizimin me gaz të lëngshëm natyror, duke zvogëluar kështu ndikimin rus. Qasja e re e republikanëve në 2025: Një qasje e ngjashme mund të zbatohet edhe në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit për të krijuar aleanca energjetike dhe ushtarake që synojnë të përjashtojnë ndikimin e Rusisë dhe Kinës. SHBA mund të mbështesë Kosovën dhe fqinjët në zhvillimin e infrastrukturës energjetike që redukton varësinë nga furnizuesit lindorë, duke rritur sigurinë energjetike dhe ndikimin perëndimor në rajon.

Administrata e Trumpit mbështeti idenë e "Mini-Schengen" (tani e njohur si "Ballkani i Hapur"), një nismë për lehtësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave midis disa vendeve të Ballkanit. Kjo përfshinte investime në infrastrukturë, si ndërtimi i autostradave dhe rrugëve që lidhin vendet e rajonit.

Qasja e re e republikanëve në 2025 mund të vazhdojë të

inkurajojë projekte të tilla rajonale që mbështesin stabilitetin ekonomik. Për shembull, Kosova mund të përfitojë nga investime amerikane në rrjetet e transportit ose energjisë, duke lehtësuar tregtinë dhe duke forcuar lidhjet me partnerët fqinjë.

Në të kaluarën, administrata amerikane ka ofruar asistencë dhe trajnime për forcat e drejtësisë në Kosovë për të forcuar sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit. SHBA ka ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve për institucionet kosovare të drejtësisë përmes programeve të USAID dhe trajnimeve të ofruara nga FBI. Qasja e re e republikanëve në 2025:

Një administratë republikane mund të ofrojë mbështetje të ngjashme, duke shtuar ndihmën në teknologji dhe ekspertizë për të ndihmuar Kosovën të ndjekë dhe dënojë rastet e korrupsionit në nivelet më të larta të qeverisë. Kjo mund të përfshijë një rishikim të ndihmës ekonomike të lidhur me përmirësimin e reformave konkrete në drejtësi. SHBA ka zhvilluar ushtrime ushtarake si "Defender Europe", ku Kosova ka marrë pjesë së bashku me aleatët

perëndimorë. Këto ushtrime përmirësojnë kapacitetet ushtarake të Kosovës dhe kontribuojnë në stabilitetin rajonal. Kosova ka marrë pjesë në këto ushtrime përmes bashkëpunimit me NATO-n dhe SHBA-në, duke forcuar kapacitetet e sigurisë dhe mbështetur angazhimet ndërkombëtare.

Qasja e re e republikanëve në 2025: Administrata e re republikane mund të rrisë mbështetjen për Forcat e Sigurisë së Kosovës përmes trajnimeve të avancuara dhe furnizimit me pajisje të sofistikuar. Po ashtu, mund të ketë më shumë angazhime ushtarake dypalëshe me Kosovën, duke forcuar mbrojtjen dhe sigurinë rajonale. Këta shembuj konkretë ilustron mënyrën sesi një administratë republikane mund të veprojë për të ruajtur ndikimin e saj në rajon dhe për të mbështetur stabilitetin dhe zhvillimin e Kosovës në mënyrë më të qëndrueshme dhe të qartë. Për këto objektivat të republikanëve lidhur me Ballkanin Perëndimor dhe Kosovën, pritet që të dëshmohet praktika e përgjithshme shoqërore në Ballkanin Perëndimor dhe veçanërisht në Kosovë.

20 milionë euro për infrastrukturën teatrore

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, ka bërë me dije se ka përfunduar rinovimi i tërësishëm i teatrit të qytetit "Muharrem Qena" në Mitrovicë.

Ai ka thënë se kjo është dëshmia e radhës e përkushtimit të qeverisë për të krijuar kushte të dinjitetshme për artistët dhe publikun artdashës. "Ky modernizim i hapësirës së teatrit të Mitrovicës bëhet edhe në nderim të figurës së Muharrem Qenës, njërit ndër artistët më të veçantë të Kosovës. Gjatë mandatit tonë kemi investuar me seriozitet në infrastrukturën kulturore të vendit, e cila kishte degraduar në mungesë të përkujdesjes shtetërore. Me prioritet të veçantë po e trajtojmë infrastrukturën teatrore në gjithë vendin. Kemi rinovuar amfiteatrin e Pallatit të Rinisë në Prishtinë, derisa punimet



kanë përfunduar edhe në Shtëpinë e Kulturës 'Ukë Bytyçi' në Suharekë, e cila ka amfiteatrin e saj", ka thënë

Çeku. Ai ka theksuar se punimet e restaurimit po vazhdojnë në ndërtesën kryesore të Teatrit

Kombëtar të Kosovës që pritet të përfundojnë në pjesën e dytë të vitit 2025. "Pas hartimit të projekteve zbatuese, në fazë

të procedurës së prokurimit janë rinovimet e tërësishme të Teatrit të qytetit 'Adriana' në Ferizaj dhe Teatrit ODA në Prishtinë. Në Rahovec vazhdon ndërtimi i Qendrës për Arte, e cila përmban amfiteatrin brenda. Aktualisht në fazë projektimi për rinovim janë edhe Teatri i qytetit në Gjiçan, Teatri i qytetit 'Avdush Hasani' në Podujevë si dhe ndërtimi i amfiteatrit të ri të Prishtinës në aneksin e ish-Rilindjes. Në fillim të vitit 2025 nis hartimi i projektit për ndërtesën e re të Teatrit të qytetit 'Bekim Fehmiu' në Prizren. Vlera totale që kemi investuar dhe zotuar për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës teatrore në Kosovë është afër 20 milionë euro. Me këtë përkushtim teatri nuk është trajtuar asnjëherë më parë", ka deklaruar ministri Çeku.

Rama takon komandantin e KFOR-it, diskutojnë për sigurinë në kryeqytet

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduani. Rama ka bërë me dije se në takim me komandantin e KFOR-it kanë diskutuar për sigurinë në

kryeqytet. "Mirëprita në Odën e Kryeqytetit komandantin e misionit të KFOR-it të udhëhequr nga NATO, gjeneralmajor Enrico Barduani. Diskutuaam për sigurinë në Prishtinë, dhe gjeneral Barduani rikonfirmoi përkushtimin e

KFOR-it për sigurinë e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Jemi falënderues për punën dhe angazhimin e tyre në mbështetje të paqes dhe sigurisë në kryeqytetin tonë dhe mbarë vendin", ka shkruar Rama në "Facebook".



Brenda spitalit në Ferizaj: Lagështi, ushqime të pasigurta, orendi të vjetra

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Me të hyrë në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt - rreth 30 kilometra larg Prishtinës - përballeni me një realitet të zymtë: grumbuj qytetarësh që presin para sallave të operacionit, të shqetësuar për familjarët e tyre.

Shumë nga ta mbajnë në duar qese plastike, të mbushura me ushqime dhe pije.

Stafi aty punon pandërprerë dhe lëvizjet e tij pengohen shpesh nga vizitorët. "Përse të gjithë këta njerëz në korridor?", iu drejtua një infermiere rojës së sigurisë, teksa ekipi i "Radios Evropa e Lirë" ishte i pranishëm aty, një paradite në fundtetor. "Nuk kam se çfarë t'iu bëj", iu përgjigj shpejt roja dhe infermierja u largua përmes korridorit të ngushtë.

Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj është një prej shtatë spitaleve rajonale të Kosovës, të cilat funksionojnë nën ombrellën e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK). Ky spital ka disa reparte, përfshirë: Emergjencën, Pediatri, Kirurgjinë, Gjinekologjinë, Ortopedinë e të tjera.

Kushtet në shumë dhoma që i ofrojnë këto shërbime nuk duken të mira.

Në ambientet e Gjinekologjisë kishte rrjedhur ujë nëpër mure nga shiu. Në Kirurgji, bombolat e oksigjenit dukeshin në korridorë, në mungesë të sistemit të instaluar në mure. "Kushtet janë kështu siç po i shihni edhe



vetë. Çka të bëj?", i tha "Radios Evropa e Lirë", Z. M., një paciente e shtrirë në Ortopedi. Edhe në këtë repart dollapët ishin të dëmtuar dhe muret jo të mirëmbajtura. "Kujdesi është mirë, por me mua rri këtu edhe vajza ime", tha Z. M., e cila priste t'i nënshtrohej operacionit për këmbën e thyer.

Ortopedia nuk ka sallë të veçantë për operacione, por shfrytëzon ato të përbashkëta dhe i ka në dispozicion dy ditë në javë.

Në disa ambiente të spitalit mund të vërehen edhe improvizime si për ofrimin e shërbimeve ashtu edhe në

vend të riparimeve.

Kushtet jo të mira në këtë spital i nxori në pah edhe Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin e sivjetmë. "Në objektin ku aktualisht është duke funksionuar spitali i Ferizajt, reparti i Kirurgjisë dhe i Urologjisë përdorin dy salla operative - secili i ka ditët e caktuara dhe ndajnë sallat edhe me repartin e Otorinolaringologjisë. Reparti i Ortopedisë kishte improvizuar një sallë operative, por që nuk i plotëson kushtet elementare për punë, sepse fizikisht është larg dhomave të pacientëve, larg dhomës së sterilizimit. Kjo paraqet rrezik për infeksione

për pacientët që operohen në këtë repart", u tha, mes tjerash, në raport.

Udhëheqësit aktualë të Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj thanë se ShSKUK-ja është në dijeni për kushtet aty. Ushtruesi i detyrës së drejtorit, Fikret Arifi, tha se po bën përpjekje që me buxhetin që ka, t'i bëjë disa rinovime.

Në ShSKUK nuk deshën të flasin shumë, vetëm se pranuan se "kushtet aty nuk janë të mira". "Edhe në ato kushte, aty trajtohen raste dhe kryhen operacione të shumta", tha një zyrtar i ShSKUK-së.

Javën e kaluar "Radio Evropa e Lirë" raportoi edhe për mungesën e biokimistëve në Spitalin e Ferizajt për më shumë se tre vjet.

Arifi tha se punën e tyre aty e kryejnë kryesisht laborantët. E me kushte njësoj të rënda, ndoshta edhe më keq, duket kuzhina e spitalit, nga e cila ushqehen pacientët.

E vendosur në një ambient të mbyllur, pa ajrosje, me myk e lagështi, kuzhina ishte e stëmbushur me orendi të vjetra dhe me artikuj të lënë vend pa vend.

Ekipi i "Radios Evropa e Lirë" pa frigoriferë që nuk mbylleshin dhe ushqime, si mish pulë, që duhen ruajtur në temperatura të ftohta, por që

ishin lënë jashtë frigoriferëve. Në kushte anonimiteti, stafi i tha REL-it se mjekët dhe infermierët nuk ushqehen prej aty - "edhe kur ushqehen, marrin vetëm bukë e djathë".

Inspektorati Sanitar, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, ka inspektuar këtë kuzhinë dhe në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë" tha se "kushtet higjieno-sanitare ishin mesatarisht të mira".

Sipas Inspektoratit, kuzhina ka pajisje ftohëse funksionale, por është në procedurë të furnizimit edhe me të tjera.

Inspektorati tha se "ka dhënë vërejtje me afat të caktuar për ngritjen e nivelit të higjienës, për vendosje të rrjetave në dritare në hapësirën e punës dhe për ventilim më të mirë". Ai nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it për temperaturën e lartë në kuzhinë dhe për mënyrën se si ruhen apo renditen ushqimet.

Problematikat e tilla nuk janë të pranishme vetëm në spitalin e Ferizajt.

Edhe spitalë të tjera në Kosovë përballen me sfida të ngjashme infrastrukturore dhe menaxheriale.

REL-i ka raportuar disa herë për mungesë barnash, papastërti dhe pritje të gjata për shërbime.




Tri komuna të udhëhequra nga PDK-ja, kampione për transparencë buxhetore

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Tri komuna të udhëhequra nga kryetarët e Partisë Demokratike të Kosovës, komuna e Drenasit, e Vushtrrisë dhe e Hanit të Elezit, kanë arritur maksimumin prej 100 pikëve në Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2023, raport i përvitshëm i Institutit GAP që synon ta rrisë

llogaridhënien dhe qasjen e qytetarëve në informacionet buxhetore në nivel lokal. "I përgëzojmë kryetarët Ramiz Lladrovci, Ferit Idrizi dhe Mehmet Ballazhi për punën e mirë, përkushtimin dhe angazhimin në ndërtimin e besimit të qytetarët. Këto komuna janë pasuar nga komuna e Ferizajt që është vlerësuar me 95 pikë, si dhe ajo

e Kaçanikut me 94 sosh, të cilat, po ashtu, janë ranguar lart në këtë raport. Për shkak teknike, komuna e Mitrovicës, e Prizrenit dhe e Skenderajt nuk kanë qenë pjesë e gjetjeve të këtij raporti. Ky është modeli qeverisës i PDK-së: transformues, zhvillimor dhe gjithëpërfshirës, i cili i duhet Kosovës edhe në nivelin qendror", ka njoftuar PDK-ja.



Buxheti 2025: Rritje fondesh për mbrojtje, infrastrukturë...

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Projektligji mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025 shqyrtohet sot në Kuvendin e Kosovës. Projektbuxhetin në vlerë prej 3.6 miliardë eurosh, Qeveria e Kosovës e miratoi më 30 tetor. Vlera e tij është për 9 për qind më e lartë se e buxhetit të vitit 2024 prej 3.3 miliardë eurosh.

Në ditën e miratimit në qeveri, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se gjatë katër vjetëve të qeverisjes së partisë së tij, Lëvizjes Vetëvendosje, buxheti i Kosovës është rritur "vit pas viti si asnjëherë më parë".

Në dekadën e fundit buxheti i Kosovës ka shkuar duke u rritur. Dallimi në mes të vitit 2015 dhe 2025 është mbi 2 miliardë euro.

Projektbuxheti parasheh rritje gati në të gjitha kategoritë e shpenzimeve, por më së shumti në subvencione dhe transfere.

Këto janë fonde të siguruar nga shteti për të ndihmuar kompani, persona fizikë ose sektorë të veçantë të ekonomisë si, p.sh., bujqësia. Kategoria për shpenzime kapitale do të ketë, po ashtu, rritje për 71 milionë euro krahasuar me buxhetin e këtij viti.

Nga 3.5 miliardë euro sa parashihet të jetë buxheti i vitit të ardhshëm, pjesa më e madhe pritet të ndahet për kategorinë subvencione dhe transfere.

Rritje, krahasuar me këtë vit, do të ketë edhe kategoria për paga dhe shtesa për 111 milionë euro. Në këtë kategori ky veprim u mor për ta mbuluar rritjen e pagave dhe të pensioneve.

Në fund të muajit të kaluar, Qeveria e Kosovës mori vendim për t'i rritur pagat për rreth 90 mijë punëtorët e sektorit publik - për 55 euro nga muaji janar dhe për 55 euro të tjera nga korriku i vitit të ardhshëm.

Rritje të buxhetit vitin e ardhshëm do të kenë edhe disa nga institucionet qendrore të shtetit, përfshirë ato në sektorin e mbrojtjes, sigurisë, shëndetësisë dhe infrastrukturës rrugore.

Mes të tjerash, të dhënat tregojnë se buxheti i Ministrisë së Financave do të jetë më i larti, i Ministrisë së Mbrojtjes do të rritet për më shumë se 54 milionë euro krahasuar me këtë vit, ndërsa i Ministrisë së Infrastrukturës për rreth 47 milionë.

Nga institucionet qendrore të Kosovës, buxhetin më të lartë në vitin 2025 do ta ketë



Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa më të voglin do ta ketë Zyra e Presidentes.

Në Projektbuxhetin për vitin 2025 thuhet se gjatë vitit aktual ekonomia e Kosovës pritet të rritet për 4.5 për qind, duke vazhduar trendin e rritjes edhe në vitin e ardhshëm,

përkatesisht për 5.6 për qind. Kontributi kryesor në rritjen ekonomike gjatë vitit 2025 thuhet se do të vijë nga konsumi privat, investimet private dhe publike, por edhe nga eksportet e mallrave dhe shërbimeve.

Buxheti i Kosovës zakonisht mbushet nga të hyrat e

Doganës dhe të Administratës Tatimore të Kosovës.

Shqyrtimi i sotëm është i pari në Kuvendin e Kosovës. Projektbuxheti duhet të dalë edhe në shqyrtim të dytë, ndërsa në raste të caktuara del edhe në të tretin. Ai duhet të miratohet më së largu deri në fund të këtij viti.

BQK-ja: Raporti i Komisionit Evropian vlerëson përpjekjet tona për përafrim me BE-në

Bashkimi Evropian ka vlerësuar stabilitetin e sektorit bankar të Kosovës dhe reformat e ndërmarrë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në Raportin për Kosovën 2024

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Komisioni Evropian ka publikuar raportin e tij të fundit mbi përparimin e Kosovës drejt procesit të integritimit evropian, në të cilin ka vlerësuar zhvillimet kryesore të sistemit financiar dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), duke identifikuar fushat që kërkojnë përafrim të mëtejshëm me standardet e BE-së. Sipas BQK-së, raporti vlerëson sistemin bankar si të qëndrueshëm dhe me një ritëm të fuqishëm të zgjerimit, me nivele të larta kapitalizimi dhe rritje të konsiderueshme të kreditimit dhe depozitave në krahasim me vitet paraprake. "Në këtë kontekst, vlerësohet miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit dhe sugjerohet puna e vazhdueshme për zbatimin e Direktivës dhe Rregullores për Kërkesat Kapitale. Raporti në veçanti vlerëson progresin e konsiderueshëm në krijimin e një strukture adekuate të

qeverisjes së BQK-së pas emërimit të guvernatorit të ri dhe kompletimit të Bordit Ekzekutiv. Për më tepër, sipas Raportit, Plani i ri Strategjik pesëvjeçar i BQK-së, i lansuar në fund të vitit 2023, pritet ta forcojë efikasitetin e saj operacional", ka njoftuar BQK.

Më tutje, theksohet se raporti vlerëson kontributin e BQK-së për trajtimin e pastrimit të parave përmes miratimit të kornizës mbikëqyrëse të bazuar në rrezik dhe nënshkrimin të një memorandumit të mirëkuptimit me Njësinë e Inteligjencës Financiare që përforcon edhe më tej përkushtimin e vendit ndaj standardeve ndërkombëtare në luftimin e krimeve financiare. "Në këtë kontekst, raporti vlerëson progresin e BQK-së në luftimin e falsifikimit të parasë dhe tërheqjen nga qarkullimi të parasë të falsifikuara. Raporti përmend edhe avancimet e tjera si mundësimi i IBAN te IFJB-të që shënon një hap të rëndësishëm në avancimin e shërbimeve të pagesave dhe përfshirjes financiare.



Gjithashtu, vlerëson anëtarësimin e BQK-së në Rrjetin e Financave dhe Bankingut të Qëndrueshëm që përafron sistemin financiar me standardet ndërkombëtare të qëndrueshmërisë përmes integritimit të parimeve të ESG në sektorin bankar", thuhet në njoftimin e BQK-së.

Në raport janë identifikuar edhe fushat në të cilat kërkohen avancime të mëtejme duke përfshirë monitorimin e kujdesshëm të rritjes së kredive, avancimi i sistemit të pagesave, përafrimi i mëturshëm me legjislacionin evropian në fushën e sigurimeve, pagesave dhe

tregjeve të kapitalit. "BQK-ja mbetet e përkushtuar në zhvillimin e kornizës ligjore dhe infrastrukturës financiare të nevojshme për ta mbështetur rritjen ekonomike dhe stabilitetin afatgjatë në pajtim me mandatin e saj", është thënë në njoftimin e BQK-së.

Përplasjet e Ismail Qemalit me Sulltanin

Nga: Evarist BEQIRI

“Fryte dritë e Shqipërisë, / jashhtë nga qytet i errët, / Ti veç dermën dhëlpërisë / E të gëzoç na të mjerët. / Ti që kur dole në jetë, / Që kur bëri nëna djalë, / Kokën e mbajte përpietë / Edhe shpirtin zjarr e valë”.

Vargje kushtuar Ismail Qemalit nga poeti Dhamian Strati (i njohur edhe si Dush Strati ose Duçe Jorgo Baba), botuar tek “Kalendari Kombiar”, i vitit 1900.

Dinjiteti njerëzor ka një rol kyç në lëmin e lidërshiptit, i cili i tejkalon barrierat kohore dhe kulturore. Ky princip është pa aq i vlefshëm në jetë sa është edhe tek udhëheqësia. Respektimi i dinjitetit njerëzor vendos themelet mbi të cilat krijohet një mjedis pozitiv dhe produktiv. Ai mund të ushtrojë një fuqi të jashtëzakonshme transformuese tek udhëheqësia. Jo më kot ky parimi themelor gjendet në themel të shtetit të së drejtës. Dinjiteti njerëzor është një e drejtë e pandashme dhe e patjetërsueshme, të cilën e gëzon çdo qenie njerëzore. Ky shkrim përpiqet të ilustrojë vlerën që ka kuraja dhe dinjiteti tek udhëheqësia virtuoze. Kuraja dhe dinjiteti njerëzor janë dy anë të së njëjtës medalje. Në një shkrim të shkurtër, por shumë domethënës që gazeta “Le Moniteur Oriental” ka botuar me titullin “Shënimet e ditës”, në Kostandinopojë, më 23 mars 1899, afro një vit para azilit vullnetar politik të Ismail Qemalit, flitet për një darkë të shtruar nga ambasadori britanik në Stamboll, Sir Nicholas Roderick O’Conor, për nder të ish-kryeministrit britanik, Lordit Rosebery. Në

këtë darkë ishin ftuar disa personalitete të rëndësishme në Stamboll, ku përfshihet Ismail Qemal bej Vlora, ambasadori i Italisë në Stamboll Pansa, koloneli dhe znj. Ponsonby, zonjusha Milner, z. De Bunsen, dragomani i parë, Adam Block, sekretari i ambasadës, Scott, dhe z. Èaterfield. Për këtë episod Ismail Qemali ka folur edhe në kujtimet e tij...

Kur Ismail Qemali shërbente si anëtar i “Conseil d’État” (Këshillit të Shtetit), njoftohet gjatë një dreke me ambasadorin britanik në Stamboll, Sir Nicholas O’Conor, se kishte ardhur një letër nga Lordi Rosebery, ish-kryeministri britanik në vitet 1894-1895. Në këtë letër, ai i bënte me dije se do të vinte në Stamboll dhe donte të njihet me Ismail Qemalin. Ai e pranon ftesën dhe ditën e caktuar meqë u ndodh në Pallat, i bën me dije Sulltanit se do të ishte për darkë bashkë me ish-kryeministrin britanik dhe e pyeti nëse kishte ndonjë porosi për të. Por, Abdyl Hamidi i çon fjalë se nuk dëshironte që ai të merrte pjesë në darkë dhe t’i kërkonte ndjesë ambasadorit për këtë.

Përunjësia pa kurrfarë arsyeje, para një teke të tillë të Sulltanit, do ta bënte Ismail Qemalin të dukej qesharak para Lordit Rosebery dhe ambasadorit britanik. Për Ismail Qemalin, ruajtja e dinjitetit njerëzor vlen më tepër se kënaqja e tekave të sulltanit. Argumentet e Ismail Qemalit për të përligjur pjesëmarrjen e tij në darkë ranë në vesh të shurdhër.

Një nga pjesëmarrësit në këtë darkë, diplomati britanik Sir Maurice de Bunsen, do të shkruante në ditarin e tij: “Ismail Qemali është një nga të



paktët që guxon të vijë në Ambasadë. Asnjë turk me pozita nuk lejohet të bëjë vizita ose të vijë për darkë në një Ambasadë pa lejen e Sulltanit, e cila shpesh refuzohet. Shumë po internohen përditë, dhe një gjendje terrori mbretëron kudo, e shkaktuar nga tmerri që ka Sulltani nga çfarëdolloj lëvizje liberale kundër tij”. Sulltani i dërgoi të gjithë miqtë e tij në Pallat një e nga një për t’i mbushur mendjen. Pavarësisht kërkesave të sulltanit, Ismail Qemali shkoi në darkë dhe i shkroi paraprakisht një letër Sulltanit, në të cilën i thoshte se e dinte se duke mos iu bindur urdhrat të eprorit të tij perandorak, po kryente një akt që meritonte ndëshkim, por në këtë rast dinjiteti i tij personal dhe interesat e Sulltanit kërkonin që ai të mos e refuzonte këtë ftesë. Ai i bën me dije sulltanit se do të kthehej të nesërmen për të prit urdhrat e tij. Dhe, ashtu bëri, shkoi të nesërmen në Pallatin Jildiz, për të prit ndëshkimin dhe i tregon sulltanit për bisedat me Lordin Rosebery. Abdyl Hamidi

II nuk ia përmendi më këtë punë.

Një episod tjetër kuptimplotë do të zhvillohej në 31 dhjetor 1908, kur Sulltan Abdyl Hamidi II, shtroi një darkë për nder të parlamentarëve osmanë të sapo zgjedhur. I vetmi deputet i opozitës, që refuzoi ftesën e Sulltanin ishte lideri i Partisë Liberale, Ismail Qemali. Këtë fakt e pasqyrojnë disa shkrime të shtypit ndërkombëtar të kohës si për shembull, gazeta kanadeze “The Gazette”, (Montreal, 4 shkurt 1909), që meriton të analizohet me kujdes, apo gazeta franceze “Le Temps” e 30 prillit 1909. Ismail Qemali e shikonte këtë darkë pajtimi si të pakuptimtë dhe të padënjë, ku deputetët shndërroheshin në puthadorë të Sulltanit.

Karakterit është thelbi i lidërshiptit virtuoze. Dhe, në momente delikate ai del në pah duke treguar personalitetin e njeriut. Në themel të lidërshiptit nuk qëndrojnë as titujt, as postet, as gradat, as vjetërsia, as eksperiencia, por qëndron karakteri dhe aftësia për të

ndikuar të tjerët. Kuraja është një nga ato cilësi të karakterit pa të cilën lidërshipti nuk mbijeton dot. Jo më kot Winston Churchill do të shprehej se: “Kuraja me të drejtë vlerësohet si e para ndër cilësitë njerëzore ... sepse është ajo që i garanton të gjitha cilësitë e tjera”.

Lidërshipti dhe pushteti nuk janë e njëjta gjë. Madje shpesh ato janë në kundërshti midis tyre. Historia na tregon plotë raste, në të cilat qëndrimi për një kohë të gjatë në pushtet, nuk përkthehet domosdoshmërisht në arritje pozitive. Përkundrazi, shpesh qëndrimi i stërzgjatur në pushtet dhe zvarritja pas tij, sjell pas edhe kaljen e lidërshiptit. “Në fund, nuk janë vitet e jetës tuaj që kanë rëndësi. Por është jeta në vitet tuaja”, thoshte Abraham Lincoln.

Pushteti, ashtu si vjen edhe ikën, ndërsa lidërshipti është diçka e brendshme që mbetet te ju dhe askush nuk mund t’ua heqë. Thelbi i lidërshiptit është forca morale e karakterit dhe jo zvarritja pas pushtetit. Lideri duhet t’i vendosë fre egos së tij, duke vendosur interesin e përgjithshëm mbi gjithçka.

Në qoftë se ju mposhteni nga uni dhe bota e ngushtë e dëshirave dhe interesave vetjakë, atëherë keni humbur forcën e lidërshiptit. Egoja personale është armiku kryesor i lidërshiptit. Lidërshipti ka të bëjë me perceptimin. Me perceptimin që ju keni për veten dhe për të tjerët, por edhe me perceptimin që të tjerët kanë për ju. Shpesh perceptimi që ju keni për veten, nuk përputhet me perceptimin që kanë njerëzit përreth për ju. Sa më të ngjashme të jenë këto dy perceptime, aq më afër realitetit është vlerësimi për lidërshiptin.

Dështimi i atentatit ndaj kryeministrit të Perandorisë Osmane, në shenjë hakmarrje për Ismail Qemalin

Nga: Hasan BELLO

Në vitin 1911 kontradiktat e shqiptarëve me xhonturqit arritën kulmin. Kryengritjet shpërthyen nga të gjitha anët. Për shtypjen e tyre, qeveria osmane dërgoi disa ekspedita, të cilat nuk arritën asnjë rezultat.

Në Parlament, lufta politike ishte po aq e ashpër. Gjatë një seance deputeti xhonturk i Serezit (qytet në Greqinë e sotme), Dervish beu qëlloi me shuplakë Ismail Qemalin. Ky akt bëri përshtypje shumë të keqe. Vetëm gjakftohtësia e disa deputetëve i ndaloi deputetët shqiptarë (Esat Toptanin), që të mos përdornin armët. Edhe ministri i Brendshëm, Talat pasha e ndonjë deputet tjetër i Komitetit Xhonturk, bënë përpjekje për ta evituar ndonjë skandal akoma më të madh në Parlament.

Në pushim të seancës, deputetët shqiptarë shkuan në zyrën e kryetarit, i cili nga frika apo ndonjë arsye tjetër, nuk gjendej aty. Ata i deklaruan nënkryetarit se, shqiptarin më mirë ta vrasësh sesa ta qëllosh. Kjo punë nuk ngeli me kaq. Përveç indinjatës së thellë që shkaktoi ky incident te shtypi dhe kolonitë shqiptare, ai shoqërua me takime dhe organizimin e një kryengritje të përgjithshme.

Ndërsa, xhonturqit bënë përpjekje për normalizimin e situatës. Por, një dëshmitar i kësaj skene, që nuk kishte treguar asnjë emocion dhe reaksion të dukshëm, kishte marrë një vendim të rëndësishëm. Ai ishte deputeti kosovar Nexhip bej Draga, i cili sipas zakonit shqiptar e konsideroi këtë si një ofezë kombëtare, që mund të shlyhej vetëm me gjak.

Nexhip bej Draga mendoi se diçka e tillë do të lahej me



vrasjen e kryeministrit, Ibrahim Haki Pashës. Për të kryer atentatin, Dervish Hima i sugjeroi atij një student nga Elbasani, Salih Hoxhën, i cili ishte në vitin e fundit të Akademisë Ushtarake. Ky i fundit e pranoi me entuziazëm këtë mision kaq delikat. Ndërsa,

Nexhip beu mori përsipër të gjitha shpenzimet.

Për realizimin e atentatit, Salih Hoxha braktisi studimet dhe për disa ditë u vendos në dhomat e hotelit të njohur në Stamboll. “Hotel des princes”, në lagjen Pera e cila ndodhej afër Ambasadës britanike. Pas

atentatit ishte planifikuar që ai të largohej me vapor jashtë Perandorisë Osmane.

Por, ajo që ndodhi ishte një gjë shumë e çuditshme, e cila për mendimin tim është një nga skupet më të mëdha në historinë e gazetarisë evropiane. Dervish Hima si publicist dhe me shpirt revolucionar, për t’i treguar Vjenës rëndësinë e tij dhe për të fituar prioritetin e lajmit, i dërgoi një gazete të njohur austriake një shkrim ku bashkë me foton e Salih Hoxhës thoshte që nga çasti në çast pritet që të bëhej një atentat kundër kryeministrit osman, Ibrahim Haki Pashës. Kjo bëri që gazeta të nesërmen të botonte shkrimin së bashku me foton e Salih Hoxhës, e cila si rregull duhej të botohej pas atentatit. Kështu, plani dështoi dhe Salihu u detyrua të largohej në emigracion i kërkuar nga policia osmane.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Foda: Në Rumani shkojmë me energji pozitive e shumë pasion për fitore



PRISHTINË, 11 NËNTOR - Shkuarja në Rumani duhet të jetë me energji pozitive dhe shumë pasion. Ky ka qenë mesazhi i përzgjedhësit të Kombëtares së Kosovës, Franco Foda, në konferencën për media para ndeshjes më të rëndësishme të këtij edicioni në Ligën e Kombeve kundër Rumanisë në Bukuresht, që zhvillohet të premtën. Përkundër mungesave të shumta në këtë grumbullim si pasojë e lëndimeve të disa lojtarëve gjatë fundjavës, Foda është shprehur optimistë se Dardanët nga ky udhëtim mund të kthehen me rezultat pozitiv. “Vendi i parë akoma është i mundshëm por për ta arritur këtë duhet ta fitojmë ndeshjen me Rumaninë. Në tri ndeshjet e fundit kemi treguar lojë të mirë, jam përgjithësisht i kënaqur, por jo edhe tepër i kënaqur, sepse është dashur të përmirësohem dhe të shënojmë më shumë gola. Për shkak të lëndimeve duhet t’i bëjmë disa përshtatje në ekip, por nisemi me vetëbesim dhe energji shumë pozitive në Rumani. Jemi të gatshëm dhe dëshirojmë të fitojmë. Pastaj, mbetet të shihet në ndeshjet e

fundit se kush do të jetë në pozitën e parë në grup”, ka thënë Foda. Ai ka shtuar se nuk sheh shumë probleme tek mesfusha, sepse ka në dispozicion shumë lojtarë të mirë. “Sigurisht se Rumania ka kualitetet e veta, por edhe Kosova i ka kualitetet dhe do t’i shfrytëzojë. Me rëndësi është të shkojmë me energji pozitive dhe me shumë pasion atje”, ka shtuar ai. Serinë prej tri fitoreve ai e ka vlerësuar shumë të rëndësishme, por ka thënë se nuk duhet të shikohet e kaluara. “Gjithsesi, tri fitoret e fundit ishin të rëndësishme. Ishte e bukur për vendin, për lojtarët dhe për vetëbesimin. Por futboli nuk jeton në të kaluarën, por në të tashmen. Prandaj, ndeshja e ardhshme kundër Rumanisë është më e rëndësishmja. Aty duhet të tregojmë performancën tonë në fushë. Në Rumani mund të fitojmë vetëm nëse çdo lojtar jep 100% dhe shkon deri në limitet e tij”, ka deklaruar Foda. Në këtë grumbullim do të mungojnë Milot Rashica, Ermal Krasniqi, Emir Sahiti, Bersant Celina dhe Leart Paqarada. Megjithatë, Foda tha se përkundër faktit që

këto janë mungesa të rëndësishme, lëndimet janë pjesë e futbollit dhe se ky është një moment ku u jepet hapësira lojtarëve të rinj. “Fatkeqësisht, kemi disa lojtarë të lënduar. Leart Paqarada, Emir Sahiti, Ermal Krasniqi, Milot Rashica dhe Bersant Celina nuk do të jenë në dispozicionin tonë. Megjithatë, dje u këshilluam me stafin e trajnerëve dhe zgjodhëm dy lojtarë tjerë: Art Smakaj dhe Zymer Bytyqi, derisa për herë të parë në ekip janë përfshirë edhe dy lojtarë të rinj, Leard Sadriu dhe Baton Zabërgja”, ka pohuar Foda, i cili lidhur me lëndimet e Rashicës dhe Celinës tha se kanë qenë në vazhdimësi në kontakt me lojtarët, stafin dhe ekipin e mjekëve. Ai tutje ka thënë se sot një pjesë e ekipit do të stërvitet në fushë, e një në palestër. “Sot do të stërvitemi në dy grupe: lojtarët që kanë luajtur të premtën dhe të shtunën do të stërviten në stadium, ndërsa të gjithë lojtarët që ishin aktivë të dielën do të stërviten këtu në hotel, me të cilët do të zhvillojmë një program rigjenerimi. Duke filluar nga nesër, do të përgatitemi me

ekipin e kompletuar për ndeshjen e parë të premtën kundër Rumanisë. Foda beson se Kosova ka potencial për t’u përmirësuar ende dhe vazhdimisht është në kërkim të lojtarëve të rinj. “Po sigurisht Kosova ka shumë lojtarë që luajnë në ekipe e në vende të ndryshme. Sigurisht se do ta mbajmë kontaktin edhe me lojtarë që kanë potencial për të luajtur me Kosovën. Do ti mbajmë sytë hapur. Jam i bindur se ka shumë talente dhe do t’i gjejmë. Tashmë disa të rinj veçse janë këtu”, ka deklaruar ai. Sa i përket mosgrumbullimit të Vesel Demakut, i cili së fundmi i tha ‘Po’ Kosovës, Foda vuri në pah se çështja ka të bëjë me mos kompletimin e dokumentacioneve për nënshtetësinë e Kosovës. I pyetur nëse Kosova do të luajë sërish futboll ofensivë kundër Rumanisë, Foda u shpreh: “Do të mbetet të shihet. Do t’i bëjmë disa ndryshime në ekip pasi kemi të lënduar. Por përgjithësisht do të jemi ofensivë. Duhet t’i shfrytëzojmë të gjitha fazat e lojës. Kundër Rumanisë në ndeshjen e parë nuk kemi pasur fat. Në momentet e vështira kemi pësuar gol.

Parimisht do të luajmë si në shtëpi si jashtë, pra me lojë ofensive”. Sa i përket Eliot Bujupit ka thënë se me kërkesë të përzgjedhësit të Kombëtares U19, Adil Maliqi, ai do të luajë në ndeshjen e parë kualifikuese të U19 të mërkurën, e më pas do të shihet se si do të veprohet. I pyetur nëse do të luajë me dy sulmues pas rikthimit të Vedat Muriqit, Foda ka theksuar: “Nuk është shumë me rëndësi nëse do të luajmë me një, dy sulmues apo me tre. Me rëndësi të qëndrojmë të gjithë së bashku, të sulmojmë së bashku dhe të mbrohemi së bashku. Ne jemi shumë fleksibil, mund të luajmë me një sulmues, dy apo tre. Rëndësi ka të luajmë në bazë të parimeve tona. Të luajmë të bashkuar për njëri-tjetrin dhe kur humbasim topin ta rikuperojmë. E kemi parë në ndeshjet e fundit që ekipi është zhvilluar tutje, jemi shumë dominant në lojë, por ka hapësira ku mund të përmirësohem. Nuk duhet të jemi kurrë të kënaqur plotësisht. Duhet të shkojmë përpara dhe të përmirësohem dhe të qëndrojmë të uritur për sukses”, ka përfunduar Foda.

Ballkani fiton ndaj Malishevës dhe rimerr kreun e tabelës

SUHAREKË, 11 NËNTOR - Ka mjaftuar goli i Sunday Adetunjit në fund të pjesës së parë ndaj Malishevës që Ballkani të arkëtojë 3 pikë të reja, të cilat e rikthejnë në krye të tabelës së klasifikimit. Kampioni aktual i Kosovës ka

grumbulluar 25 pikë, aq sa ka edhe Drita, por që gjilanasit kanë një ndeshje të mbetur për ta zhvilluar, ndaj FC Suharekës. Malishevasit mbeten në vendin e tretë me 22 pikë, një më shumë se Prishtina e pozitës së katërt.

Pas këtij triumfi, Ballkani ka regjistruar plot 731 ditë kalendarike, pa humbje në stadiumin e qytetit të Suharekës. Albi Mall Superliga e Kosovës në futboll do të pauzojë dy javë, për shkak të ndeshjeve të kombëtareve.



Prezantohet Jean-Denys Choulet, Dardanët me synime të qarta për sfidat e nëntorit



PRISHTINË, 11 NËNTOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka prezantuar përzgjedhësin e ri në basketboll, Jean-Denys Choulet. Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku ka thënë se trajneri ka shumë përvojë ndërkombëtare dhe kjo përvojë do t'i ndihmojë Dardanët në ndeshjet shumë të rëndësishme për muajin nëntor. Dushku ka shtuar se, Dardanët do të bëjnë çmos për dy sfidat e nëntorit dhe është optimiste për rezultate

pozitive, derisa FBK do t'i ofrojë kushtet optimale përzgjedhësit të ri. Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së ka falënderuar Sponsorin Gjeneral të Përfaqësueseve të Kosovës, Bankën TEB për përkrahjen e vazhdueshme për basketbollin e Kosovës, si dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që gjithmonë është afër duke ndihmuar në projektet e FBK-së dhe duke dhënë ndihmë të madhe për basketbollin në vendin tonë. Përzgjedhësi i ri

është shprehur se do të mundohen për paraqitje dhe rezultate pozitive. "Jam shumë i nderuar që jam këtu dhe të jem përzgjedhës i Kosovës. Kam shikuar disa ndeshje në fundjavë dhe përshtypja e parë është pozitive. Kemi një grup interesant dhe do të mundohemi të japim më të mirën tonë. Shpresoj se, do të fitojmë të paktën një sfidë dhe më pas në muajin shkurt të vitit të ardhshëm të kërkojmë kualifikimin. Gjithsesi pas disa stërvitjeve do të kemi një

pasqyrë më të qartë të grupit", theksoi Jean-Denys Choulet në konferencën për media. Zëvendëssekretari i Përgjithshëm i FBK-së dhe Menaxheri i Përfaqësueseve, Adriatik Raci, njoftoi se, kanë zgjedhur trajnerin francez për shkak të përvojës së madhe të tij, i cili ka drejtuar shumë skuadra franceze, duke u shpallur kampion dhe duke pasur përvojë në arenën evropiane. Raci shtoi se, stërvitjet do të fillojnë nesër (e martë) përveç lojtarëve të

Trepçës që janë të angazhuar në FIBA Europe Cup dhe Dominic Artis. "Dardanët" në muajin nëntor do të zhvillojnë dy ndeshje si mysafirë. Më 21 nëntor do të ndeshen me Zvicrën dhe më 24 ndaj Irlandës. Takimet zhvillohet në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2027. Kosova ka një fitore dhe një humbje. Sfidat e fundit do të jenë në shkurt të vitit të ardhshëm, kur do të presim Zvicrën dhe Azerbajxhanin.

Quni: Synojmë Evropianin, duhet të luajmë me besim për 60 minuta

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Pivoti Luigj Quni është shquar me përkushtim e angazhim edhe në barazimin e rëndësishëm të Kombëtares së Kosovës në hendboll ndaj Holandës, të dielën në Prishtinë. Quni i realizoi dy gola, ndërsa dha kontribut të madh në mbrojtje e po ashtu në sulm duke krijuar hapësirë për lojtarët e tjerë. Quni e vlerëson pikën e fituar, por thotë se në Prishtinë duhet të fitohen ndeshjet për kualifikim në Evropian. "Jam jashtëzakonisht krenar për

paraqitjen tonë dhe përpjekjet e ekipit. Megjithatë, duke qenë se synimi ynë është kualifikimi në Kampionat Evropian, duhet të bëjmë hapin tjetër - të luajmë plot 60 minuta me besim dhe të sigurojmë dy pikët këtu në Prishtinë. Tifozët, të cilët në mbështesin në mënyrë fantastike në çdo ndeshje, nuk meritojnë asgjë më pak", ka thënë Luigj Quni. Ndeshja me Holandën, favoriten e grupit, ishte dramë e vërtetë. Kombëtares sonë i mungoi fati për fitore madhështore.

Ndeshja përfundoi 33:33. Atmosfera në "1 Tetori" ishte shkëlqyer, e po ashtu organizimi mori nota të larta. "Dëshiroj të shfrytëzoj rastin të falënderoj Federatën e Hendbollit të Kosovës për punën e palodhshme e të vazhdueshme, e cila na mundëson të bëjmë atë që duam: të luajmë hendboll. Falënderimet e mia shkojnë për të gjithë, nga ata në zyrë, tek ata që përgatitën arenën për lojtarët tona në shtëpi. Faleminderit shumë", ka vazhduar Luigj Quni.



WENG FAT POULTRY SH.P.K
High Quality Duck Products**Thirrje për aplikim**

Weng Fat Poultry SH.P.K., NUI 811014761, po kërkon ofertues/ kontraktor /kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

LOT 1: Renovimi dhe zgjerimi i frigodhomes ekzistuese, Veshja me panel dhe elemente percjellese e frigodhomave, Furnizimi dhe vendosja e dyerve per frigodhoma,

LOT 2 Rafta per friza;

LOT 3 Sistemi i ventilimit;

LOT 4: Furre dy dhomeshe me gaz ose energji elektrike speciale per pergatitjen e rosave.

Nr. Prokurimit 01/24 Weng Fat Poultry SH.P.K

Emri: Weng Fat Poultry SH.P.K

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: info@br-dtckosovo.com

Adresa: Polac, Skenderaj, Republika e Kosovës

Tel: +38343900082;

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, ora 14:00, në Adresë:


Weng Fat Poultry SH.P.K., Fshati Polac, Skenderaj, Republika e Kosovës.

NJOFTIM

Njoftohen organet ligjore-Noteri për vdekjen e Selim Pepaj nga Lubozhda, me datë 31 gusht 2024, në Stamboll-Turqi.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Pronari i biznesit "ADA Company" SH.P.K. me nr. Unik Identifikues: 811868621 me adrese Rruga Lidhja e Prizrenit, Nr.72 – Fushë Kosovë , Z. Azam Iseni vendose që të bëjë zvogëlimin e kapitalit nga 60,000.00 € aktual, në kapitalin e ri 36, 500.00.
- Kushtrim Halili, shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.l.e. "Hasan Prishtina".
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Bedrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale në Prishtinë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Teuta Muhadri nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Blerina Kastrati nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Qendrsa Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Fakete Nallbani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Anita Stuja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit, dëftesat e kl. 10.11.12 dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Faton Kastrati Vermicë, K.K Malishevë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. dhe diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Shqipe Goranci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Haxhi Ukshini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.



Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

